

## KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATOI LIGJIN

### “PËR NISMËN LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në seancën e fundit plenare të këtij Sesioni parlamentar, më 18 Korrik 2019, Kuvendi miratoi projektligjin “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj vendos procedurat për ushtrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve, të sanksionuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe synon përfshirjen e shtetasve në proceset vendimmarrëse, nëpërmjet propozimit të projektligjeve përpara Kuvendit.

Me ndihmën e ekspertëve të Komisionit të Venecias dhe të ODHIR-it, ligji e përafron legjislacionin shqiptar me atë për nismën ligjvënëse të qytetarëve të Bashkimit Evropian dhe përqafton standardet më të reja ndërkombëtare në këtë fushë.

Ai krijon mundësi e mjete për të gjithë individët që gëzojnë të drejtën për të zgjedhur, si dhe për organizatat e shoqërisë civile, që të propozojnë projektligje. Ai ka parashikuar lehtësi të nevojshme që nisma të bëhet publike e të mblidhen firmat e 20 000 qytetarëve zgjedhës, për t'i paraqitur ato në Kuvend. Mbledhja e nënshkrimeve elektronikisht është një risi që sjell ligji.

Ligji ngarkon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të verifikuar listën e firmëtarëve përpara depozitimit të nismës në Kuvend. Kjo garantohet përmes procedurave të rregulluara në ligj dhe nuk ka më vend për praktika të ndjekura më parë, kur në mënyrë të paarsyeshme listat e firmëtarëve verifikoheshin përmes ekspertizës në laboratorët e kriminalistikës së Ministrisë së Brendshme.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare falënderon të gjithë partnerët që ndihmuan në hartimin dhe diskutimin e këtij ligji, e në mënyrë të veçantë Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, Soros, Tiranë, organizatat simotra të shoqërisë civile, Universitetin e Tiranës, Shkodrës e Vlorës. Falënderimi ynë shkon për deputetët që e propozuan dhe e përmirësuan ligjin në Kuvend, si dhe për të gjitha institucionet që u përfshinë në diskutimin e tij.